



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Në bazë të nenit 12, paragrafi, 12.2, pika (d), lidhur me nenin 17, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008", e në mbështetje të nenit 5, nënparagrafi 1.2, pika 1.2.3, lidhur me nenin 11, paragrafi 1, pika 1.15 dhe neneve 17 dhe 20, të Ligjit Nr. 04/L-174, për planifikim hapësinor, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 30/2013" dhe nenit 7, të Udhëzimit administrativ, MMPH-Nr.05/2014, për përgjegjësit e autoritetit të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor, e konform nenit 16, lidhur me nenin 22, paragrafi 1, pika 1.7, të Udhëzimit administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për administratë të hapur në komuna dhe neneve 15, 29, pika 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datë, -----, miraton këtë:

Projekt-V E N D I M

Për hapjen e shqyrtimit publik të projekt-dokumentit Plani Rregullues i Hollësishëm për
"Zonën Ekonomike në Duhël"

Neni1

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

1.1 MIRATOHET- Vendimi për hapjen e shqyrtimit publik të projekt-dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për "Zonën Ekonomike në Duhël".

1.2 Projekt-dokumenti nga pika 1.1 e nenit 1, e këtij vendimi, përbëhet nga pjesa tekstuale dhe hartografike, të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi.

Neni 2

Konsultimet publike

2.1 Projekt-dokumenti i cekur në nenin 1, të këtij vendimi, u lihet në dispozicion për shqyrtim publik: grupeve të interesit, qytetarëve, agjencive, departamenteve dhe organeve të tjera për shqyrtim dhe komentim, në afat prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e parë vijuese pas konfirmimit të ligjshmërisë dhe hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2.2 Organizimin e shqyrtimit publik të projekt-dokumentit nga pika 1.1 e nenit 1, e këtij vendimi, do ta bëjë Autoriteti Përgjigjes për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinorë, (Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis) në Komunën e Suharekës, përmes njoftimeve publike të shkruar dhe elektronike, konform nenit 8, të Udhëzimit administrativ, MMPH-Nr.05/2014, për përgjegjësit e autoritetit të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor.

2.3 Pas përfundimit të kohëzgjatjes së shqyrtimit publik, projekt-dokumenti së bashku me një përmbledhje të shkurtër të propozimeve, komenteve, sugjerimeve dhe vërejtjeve që janë bërë gjatë diskutimit publik dhe raportin nga shqyrtimi publik të përgatitur nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis, si Autoriteti Përgjigjes për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinorë, në Komunën e Suharekës, do të kryej veprimet e parapara ligjore për finalizimin e këtij dokumenti në mënyrë ai t'i prezantohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.

Neni 3
Subjekti përgjegjës

3.1 Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Autoriteti Përgjigjes për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinorë, (Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis) në Komunën e Suharekës.

3.2 Organet tjera përkatëse kompetente do t'i kryejnë veprimet procedurale për zbatim të këtij projekt-dokumenti nga përgjegjësitë e tyre të parapara.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË

01-Nr-_____
Më datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI